



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

---

Numri i lëndës: 2023:255407  
Datë: 09.10.2024  
Numri i dokumentit: 06272861

C.nr. 23/2011

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm/Divizionin Civil, gjyqtari Njazi Morina, me bashkëpunëtorin profesional Samir Morina, në çështjen juridike të paditësit X.A.K.nga fshati D., Komuna e Malishevës, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (K. – Dega në Malishevë), për shkak të kompensimit të dëmit të shkaktuara në vlerë të pa përcaktuar, jashtë seancës gjyqësore, më datë 09.10.2024, merr këtë:

### A K T V E N D I M

I. KONSIDEROHET E TËRHEQUR padia dhe kërkesëpafia për kompensimin e dëmit të shkaktuara në vlerë të pa përcaktuar e paditësit X.K.nga fshati D., Komuna e Malishevës, për shkak se paditësi nuk e ka rregulluar legjitimitetin aktiv të tij në këtë procedurë në afatin prej 30 ditësh siç e ka detyruar kjo gjykatë me anë të aktvendimit gjatë seancës së datës 12.08.2024.

### A r s y e t i m

Paditësit X.A.K.nga fshati D., Komuna e Malishevës, në këtë gjykatë më datë 23.03.2011, ka parashtruar padinë kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (K. – Dega në Malishevë), për kompensimin e dëmit të shkaktuara në vlerë të pa përcaktuar.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur disa shqyrtime gjyqësore ku prezentë kanë qenë paditësi së bashku me të autorizuarin e tij, si dhe përfaqësuesi i të paditurës ashtu që në disa seanca radhazi (*seancat e datave: 10.02.2015; 02.04.2015; 16.10.2018; si dhe kjo e datës 12.08.2024*), gjykata ka kërkuar dhe caktuar afate me anë të cilave i është bërë e njohur fakti që paditësi duhet që të rregullojë legjitimitetin aktiv në procedurën në të cilën është duke u zhvilluar, ashtu që në seancën e fundit të mbajtur më datë 12.08.2024 gjykata ka nxjerr aktvendim procedural gjatë seancës me anë të së cilit ka detyruar paditësin që brenda një afati shtesë prej 30 ditësh të rregulloj

legjitimitetin aktiv të tij në këtë procedurë si dhe ka paralajmëruar se në të kundërtën gjykata do të vendos konform dispozitave të LPK-së.

Meqenëse paditësi X.K.e as i autorizuari i tij av. Daut Krasniqi nuk kanë arritur që të bëjnë rregullimin e legjitimiteti aktiv të paditësit në këtë procedurë kontestimore e cila është duke u zhvilluar dhe për të cilën gjykata me anë të aktvendimit në seancën e datës 12.08.2024 e ka detyruar paditësin që të ndërmer veprimet e nevojshme dhe t'i eliminoj paqartësitë që përmban padia, ku edhe është njoftuar lidhur me konsekuencat ligjore në rast se vepron ndryshe se do të konsiderohet se është tërhequr padia, ose po që se pala e kthen të pa përmirësuar do të veprohet konform LPK-së, andaj gjykata ka vepruar në harmoni me Ligjin nr. 03/L-006 të Procedurës Kontestimore (LPK-së), duke zbatuar nenin 102 i cili përcakton se: *“par.1 Kur një parashtrësë nuk arrin të jetë e kuptueshme dhe e plotë, siç kërkohet në paragrafin 2 të nenit 99, gjykata do ta thërrasë personin që e dërgon ta korrigjojë ose ta plotësojë parashtrësën. Në një rrethanë të tillë, gjykata e udhëzon palën për korrigjimet dhe për plotësimet që do të zënë vend dhe e cakton një periudhë treditore për korrigjimin dhe për plotësimin e parashtrësës; par.2 Në qoftë se parashtrësja e lidhur me afat korrigjohet, gjegjësisht plotësohet dhe i dorëzohet gjykatës brenda afatit të caktuar për një gjë të tillë, do të konsiderohet se i është parashtruar gjykatës në ditën kur është paraqitur për të parën herë; si dhe par.3 Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësja po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësja do të hidhet poshtë”*, në kuptim të kësaj norme imperative gjykata ka vendosur si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Prandaj, gjykata nuk ka mundësi të veprojë sipas padisë, në kuptim të dispozitave nga 99 par. 1 dhe par. 2, dhe 3, nenit 102 par. 1, par. 2 dhe par. 3, lidhur me 253 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË MALISHEVË,  
Departamenti i Përgjithshëm/Divizionin Civil,  
C.nr. 23/2011 më datë 02.10.2024.

Gj y q t a r i  
Nehat Qelaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate dhe i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, e cila duhet të jetë në ekzemplar të mjaftueshëm për palët dhe gjykatën.